

CESVOT
CENTRO SERVIZI VOLONTARIATO TOSCANA



Udhëzues i shkurtër



Të krijojmë... shoqata

Informacion fillestar për themelimin,
funksionimin dhe financimin e shoqatave

Nën kujdesin e shoqatës INTESA





Fotografitë në faqen 7 dhe 21 janë vënë në dispozicion nga "Casa delle Associazioni" Prato dhe ato në faqen 9 edhe 28 nga "Laboratorio del Tempo" Prato.

Përkthyer në shqip nga Anila Muço

iNTESA

formazione • ricerca • consulenza per organizzazioni non profit

Via Enrico Mattei, 293/f Lucca - tel. 0583 464297 - fax 0583 432231 - e-mail: info@associazioneintesa.it

www.associazioneintesa.it

Të krijojmë... shoqata

Informacion fillestar për themelimin,
funksionimin dhe financimin e shoqatave

përmbledhja

Faqja 4 - Premisë

Faqja 6 - Kapitulli 1. Kushtetuta

Faqja 10 - Kapitulli 2. Funksionimi


Faqja 13 - Kapitulli 3. Financimi dhe mbështetja

Faqja 17 - Kapitulli 4. Anëtarët e shoqatës

Faqja 20 - Kapitulli 5. Shoqatat vullnetare (ODV)

Faqja 24 - Kapitulli 6. Shoqatat e Promovimit Shoqëror
(Associazione di Promozione Sociale - APS)

Faqja 27 - Kapitulli 7. Forma të tjera shoqatash



Premisë

Është me kënaqësi të madhe që unë prezantoj edicionin e dytë të “Të... krijojmë shoqata” të publikuar nga Cesvot Toskana me sponsorizimin e UPI Toskana. Ky botim ka lindur falë një bashkëpunimi midis Delegacionit të Cesvot dhe Provincës së Prato-s.

Një e ide largpamëse, e shoqëruar nga një punë e gjatë, e kujdeshme dhe e përbashkët: me komunitetet e të huajve, me operatorët e sektorit, me shoqatat, me konsulentët tanë dhe ndërmjetësit kulturorë të territorit të Prato-s. Rezultati i arritur është i shkëlqyer, e tregojnë kërkesat e shumta që na mbërrijnë nga çdo anë e Rajonit; prandaj kemi realizuar këtë ribotim, një mjet pune dhe informacioni jo vetëm për delegacionet territoriale Cesvot, por edhe për institucionet që do të duan ta përdorin.

Është një shembull që tregon sesi eksperiencat pozitive të disa personave mund të jenë një shans më shumë për të tjerët dhe mundësi ngritje cilësore për të gjithë komunitetin. Udhëzuesi është shkruar nga Riccardo Bemi i shoqatës Intesa, të cilin e falenderoj publikisht për përkushtimin dhe profesionalitetin.

Ky libërth është i shtypur e i botuar në gjuhën italiane dhe është në dispozicion në gjuhën franceze, spanjolle, angleze, shqipe, rumune, arabe dhe kineze.

I menduar për të përhapur mendësinë e shoqatave tek imigrantët, udhëzuesi jep në mënyrë të thjeshtë e të menjëhershme, informacione të dobishme për themelimin, funksionimin dhe financimin e shoqatave. Mendoj që shoqatat janë edhe e mbi të gjitha, vende pjesëmarrje dhe pasurimi shpirtëror. Individit gjen aty hapësirë jo vetëm për të pasuruar botën e tij në mardhënie me të tjerët, por edhe përmirësimin e jetës së përbashkët.

Mundësia për ta lexuar në disa gjuhë, e pasuron këtë udhëzues, për faktin që përkthimet nuk janë thjesht letrare, por përmbajnë ato ngjyime kulturore që lehtësojnë përdorimin nga një sasi e madhe personash.

Shpresoj që “Të krijojmë shoqata” të japë kontributin e tij në procesin e integritimit dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, edhe atyre të huaj: përfshirja është rruga më e mirë për t’u ndjekur, për të evituar problematikat që rrjedhin nga një imigracion i lënë pas dore.

Patrizio Petrucci, President i Cesvot

Premisë

Më pëlqen ta mendoj këtë udhëzues si një manual të thjeshtë dhe praktik që mund t'i jetë në ndihmë qytetarëve për t'u orientuar në botën e vullnetarizmit.

Kjo punë është menduar për ata imigrantë që duan të strukturojnë aktivitetet e tyre në organizata.

Teksti ka për qëllim t'i shoqërojë ata në krijimin, pjesëmarrjen dhe menaxhimin e një shoqate vullnetare. Është një mënyrë për të qenë së bashku dhe për të vepruar së bashku që mund të lehtësojë rrugën e njohjes dhe shkëmbimin e kulturave të ndryshme. Për këtë arsye ky udhëzues është përkthyer në shtatë gjuhët më të folura në territorin e Prato-s.

Edhe pse i thjeshtë, teksti trajton tema komplekse në lidhje me format e ndryshme të shoqatave, të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga krijimi i çfarëdolloj shoqate dhe ligjeve përkatëse, me një gjuhë të qartë dhe të drejtpërdrejtë, e cila nuk merr parasysh përkthimin e thjeshtë, fjalë për fjalë, por përpunimin "gjuhësor-kultural" të koncepteve, për t'i bërë më të kuptueshme për lexuesin.

Projekti për krijimin e këtij udhëzuesi ka lindur rreth dy vjet më parë dhe është realizuar nga Zyra Sociale e Provincës së Prato-s dhe Cesvot me pjesëmarrjen dhe kontributin e komunave të territorit, komunitetet e imigrantëve, të specialistëve të sektorit dhe ndërmjetësve kulturorë.

Ky projekt është i suksesshëm dhe novativ dhe ka për qëllim përhapjen e gjerë të shoqatave si një mjet për pasurimin e të gjithë komunitetit.

Është motiv krenarie për ne, të kemi marrë pjesë në krijimin e një projekti që zgjerohet çdo ditë më shumë dhe ndihmon një numër gjithnjë e më në rritje përdoruesish.

Loredana Ferrara
Këshilltare për Politikën Sociale të Provincës së Prato-s

1. Kushtetuta



Ç' është një shoqatë?

Një **shoqatë** është një grup *personash* ose *subjektësh (anëtarë)* të cilët mbledhen së bashku -për arsye jo-fitimprurëse - për të kryer veprimtari të vazhdueshme *shoqërore, arsimore, kulturore* ose *sportive*. *Elementet* themelore të përbashkëta për të gjitha shoqatat janë, pra, njerëzit (*anëtarët*) dhe *qëllimi*.

Shoqatat funksionojnë në përputhje me

- *Kushtetutën italiane* (kreu 1, neni. 18 - kreu. 5, neni 38).
- *Kodin Civil* (neni 14-42)
- *Legjisllacionin e veçantë* (Ligji nr 266/1991, Ligji nr 383/2000, Dekreti ligjor Nr 460/1997, ...)

Mund të jetë e akredituar një shoqatë?

Një shoqatë mund të **njihet** nga *Rajoni* (Regione*) ose *Shteti* në qoftë se:

- pasuritë e saj janë të mjaftueshme për përmbushjen e qëllimeve
- qëllimet e saj janë të ligjshme
- statuti i saj është shkruar nga një noter

* Regione-njësi administrative dhe territoriale italiane që përfshin disa provinca (psh Toskana)



Nëse këto 3 kushte plotësohen, është mirë që shoqata të fitojë **personalitet juridik** – të nisë *një proces regjistrimi (njohje)* - që realizohet duke bërë *kërkesë (me dokumentacionin përkatës)* në *Prefekturë apo Rajon*.

Në fakt, shoqatat e njohura, ndryshe nga ato që nuk janë të njohura (Riconosciute-non riconosciute**), kanë **autonomi të plotë pasurie**: pasuria e tyre është veç nga ajo e anëtarëve dhe për t'ju përgjigjur *borxheve* të shoqatës vihet në dispozicion vetëm pasuria e shoqatës dhe jo ajo(pasuria) personale e anëtarëve ose e administratorëve.

Cili është
kapitali
minimal
i kërkuar?

Ligji parashikon që **pasuria e një shoqate të njohur** duhet të jetë e *sasisë së mjaftueshme* për të arritur qëllimet e veta, pa specifikuar *përbërjen* e saj: kështu, pasuria mund të jetë e përbërë nga ndërtesa, makina, pajisje, të holla në bankë...

** Riconoscimento: praktikë administrative e nevojshme për t'i dhënë shoqatës të ashtuquajturin "personalitet juridik" (personalitet i veçantë, i ndryshëm prej secilit nga anëtarët).

Shoqata “Jo e njohur”, mund të mos ketë pasuri, pasi ajo nuk konsiderohet *esenciale* në aktin e themelimit të saj.

Cilat janë format e kontratës së shoqatës?

Personat që synojnë të formojnë një shoqatë duhet të shkruajnë dhe të nënshkruajë një kontratë (*akti i themelimit dhe statuti*) duke zgjedhur një nga 4 llojet (nga më e lira e deri tek më e shtrenjta):

- **akt publik** i hartuar nga një noter
- **dokument i vërtetuar privat** nënshkruar në prani të një noteri
- **dokument privat i regjistruar** në Zyrën e Regjistrimit
- **shkrim privat i paçertifikuar dhe i paregjistruar** (i hartuar dhe i nënshkruar nga anëtarët e shoqatës)

Cila është përmbajtja minimale e kontratës së shoqatës?

Kontrata e shoqatës (akti i themelimit dhe statuti) duhet të përmbajë **rregulla** në lidhje me *emrin* e shoqatës, adresën, *pronat*, të qenit jo-fitimprurëse, funksionimin e shoqatës, *të drejtat* dhe *detyrat* e anëtarëve, kushtet e *pranimeve të reja*, *shpërbërjes* së

shoqatës dhe shpërndarjen e pasurive që mund të mbeten pas *shpërndarjes* së saj.




Cilat janë dokumentet që duhet të ketë një shoqatë?

Ligji nuk i detyron shoqatat të mbajnë të ashtuquajturit **libra socialë**. Megjithatë është e *këshillueshme* që të ketë të paktën libra të cilët dokumentojnë punimet dhe mbledhjet e organeve më të rëndësishme: asambleja dhe këshilli administrativ.

Nuk është e nevojshme, në përgjithësi, të mbajë **libra kontabiliteti**, vetëm në qoftë se shoqata kryen *aktivitet*e të konsiderueshme nga këndvështrimi *tatimor*, atëherë është e detyruar të mbajë kontabilitet dhe të pajiset me liçencë.

Është i domosdoshëm kodi fiskal për të gjitha organizatat, edhe ato që kryejnë vetëm *veprimtari institucionale*.

2. Funksonimi



Cilat janë organet e një shoqate?

Organet e domosdoshme të një shoqate janë: asambleja dhe këshilli ekzekutiv (administrativ).

Asambleja (e zakonshme apo e jashtëzakonshme) është organi më i lartë i shoqatës. Përbëhet nga të gjithë anëtarët dhe vendos për çështje të rëndësishme: caktimin e drejtuesit, miratimin e buxhetit, ndryshimin e statutit, shpërbërjen e shoqatës.

Këshilli ekzekutiv (i cili mund të marrë emra të ndryshëm: *Bordi i Drejtorëve, Komitetit Ekzekutiv, Këshillit Qeverisës, ...*) duhet të zbatojë **rezolutat** e asamblesë.

Statuti mund të parashikojë praninë e organeve të tjera duke përfshirë ato të kontrollit (*Bordi i revizorëve*) ose të garancisë së mirëkuptimit midis anëtarëve të shoqatës (*Bordi i arbitrave*).





Si funksionon asambleja?

Në shoqata, *vullneti* i anëtarëve shprehet nëpërmjet **asamblesë, të zakonshme ose të jashtëzakonshme**, sipas përcaktimeve të bëra në statut.

Sipas ligjit, konsiderohet e *vlefshme* asambleja ku janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve. Ligji lejon, për arsye praktike, mundësinë për të bërë një *thirrje të dytë* të asamblesë (si të zakonshme dhe të jashtëzakonshme), në të cilën vendimet konsiderohen të vlefshme, pavarësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm.

Për aktet (**kuorumi**) zbaton *parimin e shumicës së thjeshtë*: vetëm në rezolutën për *shpërbërjen* kërkon një *shumicë të kualifikuar* (p.sh gjysmat ose 2/3 e anëtarëve).

Si mund të ndryshojë statuti i një shoqate?

Anëtarët e një shoqate, të mbledhur në asamble të jashtëzakonshme, mund të **ndryshojnë statutin**, duke u kujdesur për të mbajtur një *proces-verbal*.

Si mund të mbyllet një shoqatë?

Shpërbërja dhe likuidimi i një shoqate zakonisht rregullohen nga *statuti* i cili parashikon rregullat për mbylljen e shoqatës.

Në çdo rast, procedura për shpërbërjen e shoqatës është e *lirë* por duhet të miratohet nga kuorumi *i jashtëzakonshëm* në asamblenë e përgjithshme të anëtarëve. Pasuritë e *mbetura* të shoqatës *nuk* i ndahen anëtarëve.

Cilat janë rregullat e privacy në një shoqatë?

Privacy udhëhiqet nga *Kodi për mbrojtjen e të dhënave* të vitit 2003 që përcakton një seri *kërkesash për mbrojtjen e të dhënave personale* (në veçanti, **të dhënat e ndjeshme**) që trajtohen.

Për një shoqatë është e nevojshme t'i zgjedhë me kujdes personat që do të merren me të dhënat e ndjeshme dhe t'i pajisë me *dokumentacionin ku impenjohen* të respektojnë këto të dhëna.

Duhet gjithashtu, të përmbushen *masat minimale të sigurisë* të kërkuara nga ligji për trajtimin e të dhënave me *mjete elektronike*. Në veçanti, duhet hartuar dhe *rinovuar* çdo vit, **Dokumenti Programatik i Sigurisë (Documento Programmatico sulla Sicurezza DPS)**, për të trajtuar të dhënat e ndjeshme me *teknologji kompjuterike*.

3. Financimi dhe mbështetja



Cilat janë burimet kryesore të financimit publik për shoqatat?

Burimet financiare për shoqatat mund të vijnë nga Bashkimi Evropian, Shteti dhe autoritetet lokale.

Bashkimi Evropian

- Kontributet paguhen *direkt* nga Komisioni Evropian (*kontribut i drejtpërdrejtë*)
- Kontributet paguhen në mënyrë *indirekte* - nëpërmjet Rajonit - nga Komisioni Evropian (*fonde strukturore-fondi strutturali*)

Shteti

- Kontributet *ministeriale*
- Të ardhurat nga “5 per mille”*
- Lehtësime *tatimore* të përgjithshme ose të veçanta për sektorin (*transferime indirekte*)

Rajoni

- Kontribute *rajonale*
- Lehtësime *tatimore* të përgjithme ose të veçanta për sektorin (*transferime indirekte*)

* 5 per mille: mundësia që kanë qytetarët t'i japin pa asnjë shpenzim shtesë, një pjesë (pikërisht 5x1000) të taksave të veta, një shoqate (vullnetare, amatoriale-sportive) për të financuar aktivitetet e shoqatës.



Autoritetet Lokale

- Kontributet e *Provincës*
- Kontribute sipas *zonave sociale* (p.sh. kontributet e *Shoqërisë së Shëndetësisë “Società della Salute”*)
- Kontributet (financiare ose në natyrë) të *Komunave*
- Kontributet, kompensimin e shpenzimeve dhe pagesave për veprimtari të veçanta *konvencionale* me Ndërmarrjet Shëndetësore Lokale (Azienda Sanitaria Locale-ASL), kompanitë e shërbimeve publike (të *prokurimit të drejtpërdrejtë ose të tenderit*)

Si funksionon financimi nga fondacionet private?

Kur thuhet *kontributet* nga *privatët* (qytetarë, biznese, fondacionet dhe shoqatat e biznesit, bankat, ...) kemi parasysh burimet financiare *vullnetare* të mbledhura nëpërmjet aktiviteteve të *fund raising* (ngritjes së fondeve).

Kontribute të *rëndësishme* për të mbështetur veprimtaritë e shoqatave mund të vijnë nga *fondacionet e korporatave* dhe *fondacionet bankare*.



Kapitulli 3. Financimi dhe mb shtetja

Cesvot: çfarë është dhe ç'rol luan?

Cesvot – Qendra e Vullnetarëve të Toskanës ushtron veprimtarinë e saj që prej vitit 1997, sipas legjislacionit kombëtar (Dekreti ministerial 8/10/97), me qëllim që të :”*mbështesë dhe kualifikojë aktivitetet vullnetare*”. Për këtë qëllim, sjell kontributin e saj në formën e shërbimeve në ndihmë të organizatave vullnetare të regjistruara ose jo në Rajon”.

Drejtohet aktualisht nga 26 *shoqata vullnetare me shtrirje rajonale* dhe është e pranishme me 11 *delegacione territoriale*. Cesvot ka zgjedhurat të përbëhet nga delegacione për të krijuar një kontakt më të drejtpërdrejtë me shoqatat dhe për të inkuaruar pjesëmarrje më të madhe në aktivitetet me Qendrën. Nëpërmjet selisë rajonale dhe zyrave territoriale, ofron shërbime *trajnimi, konsultime, informacione dhe ndihmë* për mbi 3 mijë shoqata vullnetare në Toskanë.

Cesvot ndihmon gjithashtu, *të punuarit në rrjet dhe bashkëpunimin e vullnetarëve dhe institucioneve*, falë tenderrave dhe shërbimeve apostafat, *mbështet projekte dhe kurse formimi* të menduara nga shoqatat vullnetare.



4. Anëtarët e shoqatës



Cilat janë të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve?

Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve rregullohen me të ashtuquajturën “kontratë të shoqatës”.

Ndër **të drejtat e anëtarëve** mund të përmendim: të drejtën për të marrë pjesë në asamblatë, të votojë, të kryejë punën vullnetare për të cilën është rënë dakord, të japë dorëheqjen nga anëtarësimi.

Ndër **detyrat e anëtarëve** përmendim: të respektojnë rregullat e statutit, të respektojnë vendimet e marra nga asambleja dhe të paguajnë kuotat e anëtarësimit.

Cilat janë rregullat e anëtarësimeve të reja?

E ashtuquajtura “Kontrata e anëtarësimit” duhet të përmbajë *kushtet* e **pranimit** të anëtarëve, në veçanti duhet të përcaktohen në bazë të *cilësive personale* për të vlerësuar kërkesën e tyre për pranim.



A mundet një anëtar i shoqatës të ndërpresë marrëdhëniet e tij me shoqatën?

Anëtari i shoqatës mund t'i *ndërpresë* marrëdhëniet e tij me shoqatën në 3 rastet e mëposhtme: **tërheqjes, përjashtimit dhe vdekjes.**

Anëtari mund të *tërhiqet* në çdo moment që ai dëshiron, përveç rastit kur është anëtarësuar për një

periudhë të përcaktuar.

Shoqata mund ta *përjashtojë* anëtarin për *arsye të vlefshme* (që i korrespondojnë mangësive të rënda).

Me *vdekjen* e një anëtari pushon lidhja e tij me shoqatën, përveç rastit kur në të ashtuquajturën “kontratë të anëtarësimit” është shkruar shprehimisht që anëtarësimi mund të jetë i trashëgueshëm.

Cilat janë përgjegjësitë e anëtarëve dhe administratorëve?

Llojet e **përgjegjësive** janë **civile, tatimore - administrative dhe penale.**

Borxheve (*detyrimeve*) të krijuara nga personat që përfaqësojnë shoqatën (kur kjo nuk është e njohur), i përgjigjet vetë shoqata me *fondin e përbashkët* dhe personat që kanë vepruar *në emër* dhe *për llogari të shoqatës*.

Në Shoqatat jo të njohura, *dënimet administrative në lidhje me tatim-taksat* prekin personin që ka kryer shkeljen.

Nuk ka *përgjegjësi penale* shoqata (jo e njohur), por vetëm personi i cili ka kryer shkeljen.



5. Shoqatat vullnetare (ODV)

Çfarë është
një shoqatë
vullnetare?

Organizimi dhe funksionimi i Shoqatave vullnetare ndjek rregullat e *Ligjit të 11 gushtit 1991, N° 266*.

Ndjek vetëm *interesat e solidaritetit* dhe nuk ka *qëllime fitimi*.

Anëtarët janë **vullnetarë**, pra ata duhet t'i kryejnë punët e veta *pa shpërbim, personalisht dhe vullnetarisht*.

Organizatat vullnetare mund të përdorin **punonjës apo profesionistë** vetëm në rast kur aktiviteti që kryejnë ka nevojë për *persona të kualifikuar*.

Cilat janë
përfitimet për
një organizatë
vullnetare?

Organizatat vullnetare mund të *regjistrohen* në **Regjistrin Rajonal të Vullnetarëve (Registro Regionale del Volontariato)**. *Kërkesa për regjistrim* e pajisur me *dokumentacionin përkatës*, duhet t'i paraqitet Presidentit të *Provincës* brenda 6 muajsh nga data e themelimit.



Përfitimet kryesore të organizatave vullnetare të regjistruara janë:

- mundësi financimi nga *kontributet publike*
- financimi i *projekteve eksperimentale* me “fondin për vullnetarët ‘
- lidhja e *marrëveshjeve* me autoritetet publike (ASL, spitale, autoritetet lokale, ...)
- pjesëmarrja në *Konsultën Rajonale* të vullnetarëve
- *fleksibilitet orari* për punën e vullnetarëve
- *lehtësime nga pikëpamja tatimore*





Cilat janë
detyrimet
e një shoqatë
vullnetare?

Detyrimet kryesore të një shoqatë vullnetare janë:

- *mosshpërblimi* i vullnetarëve: ata mund të marrin kompensim të shpenzimeve aktuale (të dokumentuara) për shpenzimet e bëra (udhëtim, ushqim, telefon, ...)
- detyrimi për të mbajtur një libër të anëtarëve, i njohur si *Regjistri i anëtarëve*
- detyrimi për të siguruar ndaj *aksidenteve e sëmundjeve vullnetarët dhe ndaj përgjegjësisë civile (responsabilità civile)*
- detyrimi i ruajtjes së *dokumenteve* të lidhura me burimet e të ardhurave

6. Shoqatat e Promovimit Shoqëror (Associazione di Promozione Sociale - APS)

Çfarë është një shoqatë e promovimit shoqëror?

Shoqata e promovimit shoqëror rregullohet nga *Ligji i 7 dhjetorit 2000, n. 383*. Kryen aktivitete të *shërbimeve sociale*, ndaj *anëtarëve* të saj dhe palëve të treta, është një organizatë *jo-fitimprurëse* dhe me respekt të plotë për lirinë dhe dinjitetin e *anëtarëve* të saj.

Ligji lejon që disa *anëtarë* dhe / ose *persona të ngarkuar me një detyrë* (p.sh. administratorët) të *paguhen* pasi të jenë pajisur me kontratë si të punësuar apo bashkëpunëtorë.

Shoqata e promovimit shoqëror i *ngjan* nga pikëpamja e strukturës, funksionimit dhe përfitimet, Shoqatës Vullnetare. Ajo dallohet nga kjo e fundit kryesisht për 3 aspektet e mëposhtme:

- në shoqatën e promovimit shoqëror *nuk egziston detyrimi* që puna e kryer nga anëtarët të jetë tërësisht vullnetare (anëtarët mund të *paguhen* për punën e kryer)
- për shoqatat e promovimit shoqëror ligji parashikon më shumë *lehtësime tatimore dhe financiare*
- vetëm për shoqatat e promovimit shoqëror është i mundur regjistrimi në një *regjistër kombëtar*



Cilat janë
përfitimet për
një shoqatë të
promovimit
shoqëror?

Shoqatat e promovimit shoqëror mund të *regjistrohen* në **Regjistrin e shoqatave rajonale të promovimit shoqëror**. *Formulari* së bashku me anekset e tij, do t'i *paraqitet* Presidentit të Provincës në territorin e së cilës shoqata ka zyrën e saj të regjistruar, 1 vit pas themelimit .

Shoqatat e promovimit shoqëror të regjistruara mund të kenë lehtësimet e mëposhtme:

- të pranojnë *kontribute* nga organet publike, BE-ja dhe organet ndërkombëtare
- të kryejnë shërbime në *konvencion* me organet publike (komuna, Rajoni, ASL, ...)

Kapitulli 6. Shoqatat e Promovimit Shoqëror (Associazione di Promozione Sociale - APS)

- të marrin *financime* të projekteve eksperimentale të Ministrisë së Mirëqenies
- të sigurojnë *fleksibilitet* orari për punën e vullnetarëve të saj
- të përfitojnë nga organet publike, *përdorimin falas të pronës së luajtshme dhe të paluajtshme*
- të jenë të autorizuar, përkohësisht, në *tregëtimin e pijeve dhe ushqimeve* (p.sh., menaxhimin e një bari) dhe ushtrimin e *veprimtarive turistike dhe strehim* (p.sh. shtëpitë e pushimit)
- të përfitojnë nga *lehtësime tatimore shtesë*

Cilat janë formalitetet për një shoqatë të promovimit social?

Detyrimet kryesore për një shoqatë të promovimit social janë:

- të formulojë *me shkrim* një të ashtuquajtur "kontratë anëtarësimi"
- *sasia e punës vullnetare në brendësi të shoqatës të jetë më e madhe sesa ajo e punës së paguar*
- përfshirjen në *aktin e themelimit* dhe *statut* të dispozitave të veçanta

7. Forma të tjera shoqatash

Çfarë është një "rreth"?

Rrethi është një shoqatë (*shpesh promovimi shoqëror*) qytetarësh, që ka qëllime *krijimtarie, kulturore dhe aktivitetesh sportive*.

Duhet t'i kryejë veprimtaritë e veta *pa qëllime fitimi*, në dobi të anëtarëve të saj, në *zonat jo të hapura për publikun*. Brenda rrethit, nëse ata janë të "**lidhur**" ose jo të lidhur me shoqata të *nivelit kombëtar*, mund të bëhet **përgatitje e tregëtim ushqimesh dhe pijesh** (*menaxhim e bar*) vetëm për anëtarët.





Çfarë është një Organizatë Jo Qeveritare (OJQ)?

Organizatat Jo qeveritare punojnë në *fushën e zhvillimit të bashkëpunimit dhe solidaritetit ndërkombëtar*. Njohja dhe hyrja në një *regjistër të veçantë të mbajtur nga Ministria e Punëve të Jashtme*, bëhet e mundur nëse OJQ-të:

- *zbatojnë programe* me afat të shkurtër dhe të mesëm në vendet në zhvillim
- zgjedhin, formojnë dhe përdorin *vullnetarët* e shërbimit civil
- *formojnë* (nga pikëpamja e aftësive profesionale) qytetarët e vendeve në zhvillim, në vendin e tyre

Çfarë është një
Shoqate Sportive
Amatoriale?

Sporti mund të praktikohet individualisht ose në grupe, në nivel amator (*jo konkurrues*) ose konkurrues me sportet e tjera (*ky i fundit quhet sport konkurrues*).

Një **shoqatë amatore sportive** është një organizatë që nxit, në mënyrë të organizuar dhe *pa qëllime fitimi*, sportin, duke ju ofruar anëtarëve të saj objektet, pajisjet dhe trajnerët për të kryer këtë veprimtari.





OJF-të (jo-fitimprurëse sociale) është një *cilësim*, i rëndësishëm vetëm nga pikëpamja *tatimore*. Këtë cilësim mund ta kenë të gjitha *format e shoqatave* që pamë më lart, për të pasur *lehtësime* ose *reduktime* tatimore ose *thjeshtësime* kontabiliteti apo procedurash tatimore.

Aktivitetet e OJF i drejtohen kryesisht personave *në nevojë* (në kuptimin e gjendjes fizike, mendore, ekonomike, sociale apo familjare), ose anëtarëve të *komuniteteve të huaj*, të kufizuar në ndihmë humanitare.

Disa institucione janë të konsideruara Jo-fitimprurëse (**On-lus) automatikisht** (për shembull: *organizatat vullnetare të regjistruara dhe organizatat joqeveritare* të njohura), pa varësisht nga kushtet që parashikon Ligji për OJF.

OJF të tjera janë të tilla (pra jo-fitimprurëse) sepse kanë ‘*zgjedhur*’ të bëjë një deklaratë në Drejtorinë e Tatim Taksave kompetente.

Le delegazioni territoriali

AREZZO

Via G. Monaco, 25/4 - 52100 Arezzo
Tel. 0575 299547 - Fax 0575 293044

del.arezzo@cesvot.it

EMPOLI

Via Salvagnoli, 34 - 50053 Empoli (FI)
Tel. 0571 530165 - Fax 0571 535977

del.empoli@cesvot.it

FIRENZE

Via Ricasoli, 9 - 50122 Firenze
Tel. 055 2654558 - Fax 055 2679407

del.firenze@cesvot.it

GROSSETO

Via Ginori, 19 - 58100 Grosseto
Tel. 0564 418447 - Fax 0564 420154

del.grosseto@cesvot.it

LIVORNO

Via degli Asili, 35 - 57126 Livorno
Tel. 0586 219632 - Fax 0586 836859

del.livorno@cesvot.it

LUCCA

Via Mazzini, 70 - 55100 Lucca
Tel. 0583 316914 - Fax 0583 318512

del.lucca@cesvot.it

MASSA CARRARA

Via Solferino, 2/a bis - 54033 Carrara
Tel. 0585 779509 - Fax 0585 757700

del.massa-carrara@cesvot.it

PISA

Via Sancasciani, 35/37 - 56125 Pisa
Tel. 050 503861 - Fax 050 2209213

del.pisa@cesvot.it

PISTOIA

Via San Bartolomeo, 13/15 - 51100 Pistoia
Tel. 0573 977542 - Fax 0573 307214

del.pistoia@cesvot.it

PRATO

Via Cambioni, 35 - 59100 Prato
Tel. 0574 442015 - Fax 0574 443861

del.prato@cesvot.it

SIENA

Via Fontebranda, 95 - 53100 Siena
Tel. 0577 247781 - Fax 0577 219202

del.siena@cesvot.it



Unione Province Toscane



UPI - TOSCANA

Palazzo Medici Riccardi, via Cavour, 1
Telefono 05527601 - Fax 055218226

CESVOT
CENTRO SERVIZI VOLONTARIATO TOSCANA

sede operativa: via Ricasoli, 9 - 50122 Firenze - Sede legale: via de' Martelli, 8 - 50129 Firenze
tel. 055 271731 - fax 055 214720 - Numero verde 800 005 363 - info@cesvot.it - www.cesvot.it